



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 305/8 prot.

Datë 19.02.2026

V E N D I M

Nr.283/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BE - IS” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemim Asfaltim i Rugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, , me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “BE - IS” SHPK, me NIPT K71412003A, dhe adresë Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Krujë
Adresa: Kruje Qender Sheshi Mustafa Merlika (Kruja).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.11.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemin Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

II.2. Në datën 25.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 10.12.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Company Riviera 2008	39,959,,076 lekë	Skualifikuar
MAKARESH	46,338,456 lekë	Kualifikuar
BE-IS	49,646,739 lekë	Kualifikuar
Kegli-Duri	50,654,579.45 lekë	Kualifikuar
SHPRESA-AL	52,047,513.25 lekë	Kualifikuar
Bami Holding	52,521,447.91 lekë	Kualifikuar
PE-VLA-KU	52,547,891.65 lekë	Kualifikuar
K.TURJA	52,806,146 lekë	Kualifikuar
NDREGJONI	53,876,046 lekë	Kualifikuar
Vellezrit Hysa	56,009,571.22	Kualifikuar
LIS KONSTRUKSION	56 507 918,20 lekë	Kualifikuar
XHAST	56,846,890.00 lekë	Skualifikuar
VAGALAT	57,182,684.07 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 10.12.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet SPE në rubrikën “Mesazhe” ka njoftuar operatorët ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, pranë Bashkise Krujë, në respektim të nenit 82/5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM me nr. 285 datë 19.05.2021” Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

II.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë, në datën 15.01.2026, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë fazë, përkatësisht:

MAKARESH	46,338,456 lekë	Skualifikuar
BE-IS	49,646,739 lekë	Skualifikuar
Kegli-Duri	50,654,579.45 lekë	Skualifikuar
SHPRESA-AL	52,047,513.25 lekë	Skualifikuar
Bami Holding	52,521,447.91 lekë	Kualifikuar
PE-VLA-KU	52,547,891.65 lekë	Skualifikuar
K.TURJA	52,806,146 lekë	Skualifikuar
NDREGJONI	53,876,046 lekë	Skualifikuar
Vellezrit Hysa	56,009,571.22	Skualifikuar
LIS KONSTRUKSION	56 507 918,20 lekë	Skualifikuar

II.6. Në datën 27.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - anulimi në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, publikuar në buletin

e njoftimeve publike nr. 10, datë 02.02.2026, me arsyen : *Bazuar në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 98/1 dhe neni 64.4 te VKM nr .285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku thuhet se: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur.... X Nuk eshte siguruar nr minimal i oferteve te vlefshme per rihapjen e konkurimit sipas kerkesave te DST dhe neni 64.4 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.*

II.5. Në datën 30.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6295 dhe nr.305/2026 prot, datë 30.01.2026 i operatorit ekonomik “BE - IS” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër, “Sistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 305/1 prot., datë 02.02.2026.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 04.02.2026, autoriteti kontraktor, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr.50 datë 04.02.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “BE - IS” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Autoriteti kontraktor ka përcjellë edhe përmes shërbimit postar vendimin e KSHA nr.50 datë 04.02.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “BE - IS” SHPK, protokolluar me tonën me nr.305/3prot., datë 09.02.2026.

II.9.Me shkresën nr.305/4 prot, datë 11.02.2026, me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së....*”, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor me kërkesë për paraqitjen e kopjes së njësuar me origjinalin të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BE - IS” SHPK, pranë autoritetit kontraktor, si operator i kualifikuar në fazën e parë.

II.10. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.1083/1 prot., datë 13.02.2026, protokolluar me tonën me nr.305/5 prot., datë 17.02.2026, me objekt “*Dërgim informacioni*”, ka përcjellë pranë KPP informacionin e kërkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “BE - IS” SHPK” SHPK mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “ Referuar dokumentacionit si me sipër në bazë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit të leshuar nga subjekti përkatës si dhe të dhenave të dokumentacionit provues , nga ana e KVO konstatohet se dokumentacioni i dorëzuar nuk përputhet me kërkesat e vlefshmerisë sipas shtojcës nr. 7 të DST respektive për procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugëve në Territorin e Njësisë Administrative Nikël, Bashkia Krujë”.

Operatori i klasifikuar nuk ka arritur të dorëzojë dokumentacionin e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në përfundim konkludojmë se operatori ekonomik nuk ka arritur të dorëzojë dokumentacionin provues të vlefshëm të referuar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sa i takon përmbushjen e kriterëve të kualifikimit kushteve të referuara në shtojcë nr.7, pikat 2.3-6.a) në nënpiken sa I takon personelit mbështetës I klasifikuar dhe teknik operatori ekonomik nuk ka paraqitur dy (2) punonjës manovratorë të mjeteve/makinierive të rënda specifikisht mungojnë dy manovrator me Dëshmi Aftësie Profesionale, Buldozierist.

Si përfundim operatori ekonomik i klasifikuar nuk ka përmbushur detyrimin e tij ligjor për dorëzimin e dokumentacionit të vlefshëm të ofertes”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1.Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1.a, të shtojcës 7, “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Ndërsa në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.6 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3-6-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik

a)Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pese) punonjës manovratorë të mjeteve/makinierive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator asfaltoshtruese→1 manovrator
- Manovrator eskavatori→1 manovrator
- Manovrator grejderi→1 manovrator
- Manovrator rruli vibrues →1 manovrator,
- Manovrator rruli asfalti →1 manovrator,

Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates), dëshmite e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatëse sipas modaliteteve të urdhrin Nr. 200, datë 16.5.2019

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorëzoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.


III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ka deklaruar

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”	
Deklarata	Përgjegje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Korrik 2025- 111 punonjes Gusht 2025 – 110 punonjes Shtator 2025- 116 punonjes Tetor 2025- 116 punonjes Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:


“BE-IS” SHPK
 Aruga “Qemal Stafa”, PE Nr. 66, Shk. 3, Ap. 26, Tiranë
 E-mail: be_is_firmreferenti@yahoo.com ; info@be-is.al
 Tel: 067 208 8124 ; 069 209 6376

	<ol style="list-style-type: none"> 1. [REDACTED] me profesion Inxhinier Ndertimi/ Profili Transport, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtnesit Teknik, i pajisur me certifikate si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”. 2. [REDACTED] me profesion Inxhinier Markshajder/Topograf, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Drejtnesit Teknik. 3. Kontrate shërbimi date 01.02.2025 me shoqërinë PLUS CLINIC shpk për ofrimin e shërbimeve mjekësore, konkretisht Zoj. Rozeta Kamberi. Mjeksi e Përgjithshme. 4. [REDACTED] me profesion Manovrator/ Buldozerist, me dëshmi të aftësisë profesionale nr. serial DM-005233, me afat vlefshmërie deri 21.08.2030, lëshuar nga DPSHTRR, i punësuar pranë shoqërisë sonë sipas kontrates individuale të punës date 03.01.2025. 5. [REDACTED] profesion Manovrator/ Buldozerist, me dëshmi të aftësisë profesionale nr. serial DM-005123, me afat vlefshmërie deri 30.07.2030, lëshuar nga DPSHTRR, i punësuar pranë shoqërisë sonë sipas kontrates individuale të punës date 03.01.2025. 6. [REDACTED] me profesion Manovrator/Eskavatorist, me dëshmi të aftësisë profesionale nr. serial 04050, me afat vlefshmërie 17.03.2027, lëshuar nga DPSHTRR, i punësuar pranë shoqërisë sonë sipas kontrates individuale të punës date 03.01.2025.
--	--

	<p>individuale te punes date 03.01.2025.</p> <p>7. [REDACTED] me profesion Manovrator/Eskavatorist, me deshmi te aftesise profesionale nr. serial 03478, me afat vlefshmerie 30.09.2026, leshuar nga DPSHTRR ipunësuar pranë shoqërisë sonë sipas kontrates individuale te punes date 03.01.2025.</p> <p>8. [REDACTED] me profesion Manovrator/Eskavatorist, me deshmi te aftesise profesionale nr. serial 04736, me afat vlefshmerie 02.11.2027, ipunësuar pranë shoqërisë sonë sipas kontrates individuale te punes date 02.02.2025.</p> <p>9. [REDACTED] me profesion Manovrator/Automakinist, me deshmi te aftesise profesionale nr. serial 02364, me afat vlefshmerie deri 10.02.2026, leshuar nga DPSHTRR, ipunësuar pranë</p>
 <p>"BE-IS" SHPK Rruga "Gornal Stajlo", Nr. Nr. 66, Sht. 3, Ap. 24, Tiranë E-mail: be_is_firmendortimi@yahoo.com ; info@be-is.al Tel: 067 208 8124 ; 069 209 6776</p>	
	<p>shoqërisë sonë sipas kontrates individuale te punes date 03.01.2025.</p> <p>10. [REDACTED] profesion Manovrator/Automakinist, me deshmi te aftesise profesionale nr. serial DM-005128, me afat vlefshmerie deri 30.07.2030, leshuar nga DPSHTRR, ipunësuar pranë shoqërisë sonë sipas kontrates individuale te punes date 03.01.2025.</p> <p>Makineri e mjete Po [x] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- *a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- *b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- *c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
- *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Ndërsa në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1,2,3,4,5 të LPP-së përcaktohet se: *1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre; 55 b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit...”

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për

dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.5.Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6 Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: **a)Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pese) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:Manovrator asfaltoshtruese→1 manovrator; Manovrator eskavatori→1 manovrator; Manovrator grejderi→1 manovrator; Manovrator rruli vibrues →1 manovrator; Manovrator rruli asfalti →1 manovrator,**

*Për cdo profil punonjesi teknik si më sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese sipas modaliteteve të urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019 Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht formularit përmbledhës të vetdeklarimit, rezulton se në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për **personel mbështetës të kualifikuar dhe teknik**, operatori ekonomik ankimues ka deklaruar punonjësit z.M.K. me profesion Manovrator/ Buldozerist, z.E.K me profesion Manovrator/ Buldozerist, z.S.M me profesion Manovrator/Eskavatorist, z.S.I me profesion Manovrator/Eskavatorist, z.F.LI me profesion*

Manovrator/Eskavatorist, z.L.L me profesion Manovrator/Automakinist, z.Xh.H me profesion Manovrator/ Automakinist, sikurse paraqitet edhe në pikën III.1.2. të këtij vendimi.

Si operator ekonomik i kualifikuar në fazën e parë, ankimuesi ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në respektim të nenit 82/5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM me nr. 285 datë 19.05.2021” *Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, dokumentacion i cili është përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr,1083/1 prot, datë 13.02.2026, protokolluar me tonën me nr.305/5 prot., datë 17.02.2026.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik ankimues, mungesës së dy Dëshmime të Aftësisë Profesionale, për manovrator Buldozierist, nga verifikimi i këtij dokumentacioni, (përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr,1083/1 prot, datë 13.02.2026, protokolluar me tonën me nr.305/5 prot., datë 17.02.2026) KPP konstaton se: për manovratorin buldozierist z.E.K ankimuesi ka dorëzuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga autoriteti kontraktor, përfshi këtu edhe dëshminë e aftësisë profesionale, me afat vlefshmërie 30.07.2030, dokumentacion i cili përputhet me deklaratimet e bëra nga ankimuesi në formularin e vetdeklarimit, duke përmbushur kështu kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për manovratorin buldozierist z.M.K, ankimuesi ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga autoriteti kontraktor (kontratën e punës të vlefshme), ndërsa sa i përket dëshmisë së aftësisë profesionale, ka paraqitur vetëm pjesën e pasme të saj, ku evidentohet se periudha e vlefshmërisë së saj, data 21.08.2030, është e njëjtë me atë të deklaruar për këtë manovrator në formularin përmbledhës të vetdeklarimit. KPP gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar, ankimuesi ka dhënë një indicie që plotëson kriterin 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, sa i takon dëshmisë së manovratorit (buldozierist). Neni 82 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcakton se “...Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal...”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet ti kërkojë sqarime operatorit ekonomik ankimues lidhur me dëshminë e aftësisë, manovrator, buldozierist për z. M.K, e pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni të rivlerësojë ofertën e ankimuesit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BE - IS” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, , me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “BE - IS” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BE - IS” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

